



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1384 Prot.

Tiranë, më 24.102018

VENDIM Nr. 224, datë 17.10.2018

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 48, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 10, datë 17.10.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Rrjeti Inxhinjrik i Tubacioneve për fibra optike Epon" Bashkia Lezhë, i cili shtrihet edhe në zonat arkeologjike "A" dhe "B"*-subjekti "NETSYSCOM" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Rrjeti Inxhinjrik i Tubacioneve për fibra optike Epon" Bashkia Lezhë, i cili shtrihet edhe në zonat arkeologjike "A" dhe "B"*-subjekti "NETSYSCOM" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi.
2. Subjekti "NETSYSCOM", duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Rrjeti Inxhinjrik i Tubacioneve për fibra optike Epon" Bashkia Lezhë, i cili shtrihet edhe në zonat arkeologjike "A" dhe "B", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al